

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

**Andi ÇELIKU** - Kryesues  
**Arjana FULLANI** - Anëtar  
**Medi BICI** - Anëtar

Në datën 21.09.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative që iu përket palëve:

**PADITËS:** Arjan Bejko

**I PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

**OBJEKTI:** *Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e një viti pune për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.  
Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë për mosrespektimin e afatit të njoftimit me dy paga mujore.  
Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës me pagën e dy muajve.*

**BAZA LIGJORE:** Nenet 143, 144, 153 dhe 155 të Kodit Punës.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 119, datë 19.03.2014 ka vendosur:**

### **Pranimin e padisë.**

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ti paguaj paditësit Arjan Bejko:

- 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës,
- 2 muaj pagë si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe
- 12 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi.

**Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3967, datë 29.10.2014 ka vendosur:**

Ndryshimin e vendimit nr. 119, datë 19.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Pranimin e pjesëshëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ti paguaj paditësit Arjan Bejko 2 (dy) paga mujore si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

**Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs pala paditëse Arjan Bejko, i cili kërkon:**

Prishjen e vendimit nr. 3967, datë 29.10.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 119, datë 19.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63/e të ligjit nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative”

## V E N D O S I

**Prishjen e vendimit nr. 3967, datë 29.10.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 119, datë 19.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.**

**U shpall në Tiranë, me datë 21.09.2016**

**Nr. 31001-00622-00-2015 Regj. Themeltar  
Nr. 00-2016-3047 Vendimi (466)**